

Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri

Shtator 2023

Tiranë, më 25 Tetor 2023: Hyrjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj në territorin shqiptar, në muajin Shtator 2023, janë 1.651.151. Ky tregues rezulton me një rritje 36,6 %, krahasuar me Shtator 2022. Daljet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj nga territori i Shqipërisë, gjatë muajit Shtator 2023, janë 1.714.585, duke shënuar një rritje me 25,0 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.


Hyrjet e shtetasve

Në Shtator 2023, numri i shtetasve shqiptarë që kanë hyrë në territorin shqiptar është 546.961. Ky numër është rritur me 22,3 %, krahasuar me Shtator 2022.

Numri i shtetasve të huaj që kanë hyrë në territorin shqiptar është 1.104.190. Ky numër është rritur me 45,0 %, krahasuar me Shtator 2022.

Gjatë nëntëmuajorit 2023, numri i shtetasve të huaj që kanë hyrë në territorin shqiptar është 8.294.600. Ky numër është rritur me 29,0 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2022 (tab.1).

Fig. 1 Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri, Shtator 2022- Shtator 2023



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Ilogaritjet INSTAT

Për publikim 25/10/2023

Daljet e shtetasve

Daljet e shtetasve shqiptarë nga territori i Shqipërisë, gjatë muajit Shtator 2023 janë 614.086. Krahasuar me Shtator 2022, ky tregues është rritur me 13,5 %.

Daljet e shtetasve të huaj nga territori i Shqipërisë gjatë muajit Shtator 2023, janë 1.100.499. Krahasuar me Shtator 2022, ky tregues është rritur me 32,5 %.

Numri i shtetasve shqiptarë të dalë nga territori i Shqipërisë gjatë nëntëmuajorit 2023, është 5.191.839, duke u rritur me 18,2 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë (tab1).

Tab. 1 Lëvizjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj

Periudha	Shtator 2022	Shtator 2023	Ndryshimi vjetor %	Janar - Shtator 2022	Janar - Shtator 2023	Ndryshimi vjetor %
Hyrje gjithsej	1.208.667	1.651.151	36,6	10.480.916	13.398.503	27,8
Shqiptarë	447.123	546.961	22,3	4.052.251	5.103.903	26,0
Të huaj	761.544	1.104.190	45,0	6.428.665	8.294.600	29,0
Dalje gjithsej	1.371.621	1.714.585	25,0	10.749.124	13.128.813	22,1
Shqiptarë	541.216	614.086	13,5	4.390.612	5.191.839	18,2
Të huaj	830.405	1.100.499	32,5	6.358.512	7.936.974	24,8

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Në Shtator 2023, rajoni me numrin më të lartë të hyrjeve të shtetasve të huaj në Shqipëri është rajoni i Evropës me 1.059.798 shtetas, pasuar nga Amerika dhe Azia Lindore /Paqësori, përkatësisht me 29.236 dhe 8.958 shtetas (tab.2).

Tab. 2 Hyrjet e shtetasve të huaj sipas rajonit

Periudha	Shtator 2022	Shtator 2023	Janar – Shtator 2022	Janar – Shtator 2023
Gjithsej	761.544	1.104.190	6.428.665	8.294.600
I. Afrika	609	1.192	3.378	8.537
II. Amerika	21.013	29.236	151.669	200.578
III. Azia Lindore dhe Paqësori	3.522	8.958	20.002	53.906
IV. Lindja e Mesme	5.013	2.564	38.639	37.018
V. Azia e Jugut	1.027	1.342	7.535	10.898
VI. Evropa	727.090	1.059.798	5.859.331	7.963.158
- Evropa Qëndrore / Lindore	65.088	95.353	389.658	572.442
- Evropa Veriore	29.808	43.032	218.826	313.990
- Evropa Jugore	566.843	795.321	4.775.544	6.271.500
- Evropa Perëndimore	55.269	100.987	401.595	634.710
- Evropa Lindore / Mesdheut	10.082	25.105	73.708	170.516
VII. Rajone të paspecifikuara	3.270	1.100	348.111	20.505

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Në Shtator 2023, krahasuar me Shtator 2022, hyrjet e shtetasve të huaj shënojnë:

- rritje, për qëllime personale me 46,8 %;
- rritje, për qëllime pushime, vizitë tek të afërm, etj. me 46,1 %;
- rënie, për biznes dhe qëllime profesionale me 34,7 % (tab.3).

Tab. 3 Hyrjet e shtetasve të huaj sipas qëllimit

Periudha	Shtator 2022	Shtator 2023	Ndryshimi vjetor (%)	Janar - Shtator 2022	Janar - Shtator 2023	Ndryshimi vjetor (%)
Hyrije shtetas të huaj	761.544	1.104.190	45,0	6.428.665	8.294.600	29,0
I. Personale	744.366	1.092.968	46,8	6.343.599	8.195.585	29,2
1. Pushime, vizitë tek të afërm, etj.	715.653	1.045.778	46,1	6.043.915	7.791.228	28,9
2. Trajtime shëndetësorë	118	11	-90,7	1.953	619	-68,3
3. Qëllime fetare	53	24	-54,7	394	347	-11,9
4. Udhëtarë transit	28.542	47.155	65,2	297.337	403.391	35,7
II. Biznes dhe profesionale	17.178	11.222	-34,7	85.066	99.015	16,4

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Metodologjia

Qëllimi i publikimit të hyrjeve dhe daljeve të shtetasve shqiptarë dhe të huaj sipas mënyrës së udhëtimit (me det, ajër, tokë dhe pikave kufitare) është matja e disa treguesëve statistikorë që lidhen me turizmin.

Përkufizime

Hyrjet: Përfshijnë të gjitha hyrjet e personave në pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë).

Hyrjet janë një koncept që i referohet të gjitha mbërritjeve. Një person që viziton disa vende njëkohësisht gjatë një viti llogaritet çdo herë si një hyrje e re.

Daljet: Përfshijnë të gjitha daljet e personave nga pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë).

Daljet masin fluksin e shtetasve që lënë vendin e referencës. Një person që lë vendin e referencës disa herë gjatë një viti llogaritet çdo herë si një dalje e re.

Vizitor: Për qëllime të statistikave të turizmit, termi “vizitor” nënkupton “një person që udhëton në një vend të ndryshëm nga vendi ku ai banon, për një periudhë më pak se 12 muaj dhe qëllimi kryesor i këtij udhëtimi në vendin e vizituar nuk është ai i një veprimtarie fitimprurëse”.

Qëllimi i udhëtimit të vizitorëve dhe turistëve përfshin vizita për:

Qëllime personale të cilat grupohen në:

1. Pushime, vizitë tek të afërm etj.;
2. Trajtime shëndetësore
3. Qëllime fetare;
4. Udhëtarë tranzit.

Kategoria e biznesit që përfshin të gjitha bizneset dhe aktivitetet profesionale jashtë ambjentit të zakonshëm.

Burimi i të dhënave: Të dhënat janë administrative dhe sigurohen nga Ministria e Punëve të Brendshme (Policia e Shtetit, Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit).

Të dhënat janë paraprake dhe subjekt rishikimi të vazhdueshëm. Për më shumë referohu:

[http://www.instat.gov.al/al/dokumentimi/cil%C3%ABsia-statistikore/Politika e Revizionimit Statistikor.](http://www.instat.gov.al/al/dokumentimi/cil%C3%ABsia-statistikore/Politika_e_Revizionimit_Statistikor.)

Diferencat statistikore midis hyrje-daljeve të shtetasve Shqiptarë apo të huaj vijnë kryesisht nga:

- Ligjit nr.71/2016 “Për Kontrollin Kufitar”, neni 17 “Lehtësimi i verifikimeve Kufitare”, ku gjatë sezonit turistik apo fluksit të shtuar, në momentet e hyrjeve të shtetasve në kufi, nuk regjistron shtetasit në hyrje;
- Procedurat lehtësuese që aplikohen për banorët e zonave kufitare të cilët kalojnë kufirin për arsye të aktivitetit të tyre tregtarë, kur kalojnë disa herë brenda ditës, nuk regjistrohen në hyrje;
- Dy-shtetësia që zotërojnë një pjesë e mirë e Shqiptarëve të cilët në momentin e kalimit të kufirit mund të deklarojnë shtetësi të ndryshme në dalje nga ajo në hyrje, etj.